

ARDIAN-CHRISTIAN KYÇYKU

Kristali dhe hienat

roman



Librarium Haemus

ARDIAN-CHRISTIAN KYÇYKU

*Kristali
dhe
hienat*

Roman

*Ku je, ti mall! Ti mall!
O jeta! Jeta!
Sa larg që zall më zall
Mezi të gjeta!*

L. Poradeci, **Kamadeva**

Librarium Haemus 2010

ARDIAN-CHRISTIAN KYÇYKU

Kristali dhe hienat

Roman

ISBN electronic: 978-606-8093-36-9

Ballina / Coperta Küdesign, ©A.-Ch. Kyçyku, Citire / Lexim,
2010

Librarium Haemus 2010

Një shkëlqim

Përkryesi i kujtimeve Rubin Shkreta pat dashur të shkulte sytë, ose të verbohej duke ngulur stilografin në kokërdhokë, pikërisht gjatë një mbrëmjeje tetori. Një tetor pa të reja. Disi mendjeerrur nga konjaku, por më tepër i zojerdhur nga të jetuarit me jetën e të panjohurve, tek shfletonte kujtimet ende të papërfunduara të një veterani që ish lindur në qytezën e vet, Rubin Shkretës i qenë rënduar qepallat, qe kredhur në njëfarë honi të këndshëm, si në brendinë e një të dashure, dhe aty i qe veguar një vezë vigane, vezulluese, prej kristali. Me një babëzi nga ato të shenjtat e fëminisë, ish ngutur ta shihte nga të gjithë kahet njëherësh, ta shihte gjer në thelb atë vezë kristali, mundësisht edhe ta prekte, mirpo ca shtëllunga tymrash të përzjerë, të kuqërremtë e të zinj kishin brofur nga të gjitha anët, dhe atij një zë pleqnor i pëshpëriste se, që të mund ta prekte me gishtat e padukshëm të syve atë vezë kristali, duhej më parë të hiqte dorë nga të gjitha, nga mllefet e ëndrrat, nga synimet e dëshirat, pra: nga vetë trupi – dhe Rubin Shkreta, vetëtimthi, njëlloj sikur

t'i kish rënë rrufeja, pat menduar se zgjidhja e vetme mbetej verbimi.

E pat përfytyruar veten atje në Strehim, mbështetur në tryezë, me sytë e bërë shoshë nga pena prej platini e stilografit, mes stërkalave të gjakut dhe pamjeve të shndërruara në gjak, tek pikonin mbi shishen e bojës, dhe ai, tashmë i verbuar, i qetë dhe i denjë për ta gëlltitur pak nga pak me shpirt atë vezë të mrekullueshme kristali, ndiqte me grykëzën e shishes së bojës pikat e gjakut të vet, si ndonjë lypës.

Pat mbetur egërsisht kureshtar ndaj vetive të asaj përzjerjeje, i bindur se faqet e shkruara me gjak e bojë, ose anasjelltas, - varej nga përqindja, - duhej të ishin magjiplote, më të hijshme edhe se vetë faqet e historisë, më drithëruese se faqet e jetës.

Nuk mbante mend sa kohë pat kaluar ashtu symbyllur, i verbuar me mend. Nata e pat gjetur në tryezë, mbi fletët e argasura të veteranit, me kokën që i zukatte nga motërzimet e pafundme e brejtëse të aq fjalive të papërkryera, të aq skenave, të aq simboleve që digjeshin nën hirin e një shqipeje të varfër, prej njeriu që ka jetuar shumë gjallë e që, së fundi, pak para lemezës së mbrame, kujton vetveten me shkrim, i torturuar nga ëmbëlsia tiranike e muzës së letrave, duke rendur i lektisur mes ndërkrerjes së të thënave të pabëra e zisë së të bërave të pathëna.

Nuk ishte verbuar; nuk ia kish dalë mbanë ta shquante, ta prekte, apo ta gëlltiste fëmijërisht vezën e kristaltë. Por as nuk ia pat rrëfyer njeriu atë vegim, ndonëse, për muaj me radhë, pa ngut, por i përbetuar, qe nisur të shkollonte kumtin e atij vegimi e sidomos të nevojës për t'u verbuar.

Nuk kishte qenë fort e vështirë për një **mjeshtër të hijes**, siç e quanin miqtë e pakët. Vegimi e paskësh burimin në një nga shumë pamjet e fëminisë së Rubin Shkretës, në të dalë të qytezës së lindjes, në kodrën e varrezave, majë së cilës, si ndonjë far i gërryer e zhgënjyer nga rrebeshet e verbërisë njerëzore, ngrihej Varri i Qyqit. Ishte njëfarë lapidari me histori mjaft të ngatërruar. Thuhej se qënkej gropa e përbashkët e një çete kreshnikësh që patën luftuar o kundër turkut, o kundër shqaut, o kundër grekut, o kundër të gjithëve bashkë, ose thjesht kundër mërzisë të pafundme e plogështuese të këtyre trojeve. Ata që patën varrosur shokët e vranë, në kthina të ngushta paqeje, ndofta falë një etjeje të zezë përsëritjeje, ishin vranë mesveti e siduket ai që pat mbetur gjallë, ish pagëzuar Qyqi. Mirpo mbi qytezë valëvitej edhe një gojëdhanë tjetër, më e pakufijtë, si të thuash, që ngulmonte të bindte se Varri i Qyqit ishte, në të vërtetë, një bashkësi e vogël shqiptarësh kurbetlinj ose nizamë, të vranë apo që kishin dhënë shpirt tjetërkund, larg sa as koha s'e dinte, mërgimtarë që e patën lënë amanet t'ua shpinin eshtrat në atdhe e që s'dihet ç'dorë mirëbërëse i pat sjellë e varrosur aty, në atë skërkë vërtet të lënë jashtë kujtesës e mëshirës së historisë.

Në atë qytezë ish lindur Rubin Shkreta. Fëmijëria e tij nuk pat qenë, për fat të keq, veçse një endje marroke, e ethshme, për të zbuluar mes pluhurit të qytezës, mes pallateve të ulët e të rrjepur nga lagështia, mes plehërave që sikur sillnin plehëra-robinja nga e padukshmja, mes gërvimës thinjëse të thashethemeve e këngëve qaramane të puntorëve përjetë të dehur të një fabrike tullash – një etje kapitëse për të gjetur qoftë edhe diçka pa emër, pa pikë rëndësie, por shkëlqimtare, ndonjë rreze kristali për shembull, rreth së cilës pafajnia të mbështillej për të

ngjizur shtyllën kurrizore të një jete që s'dukej se do të kish për të ardhme asgjë veç vetëflijimit, ose burgut për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor.

Dikur, në makthin e atyre hulumtimeve, as vetë s'e dinte si, kish zbuluar se në qytezë kish ardhur një cast kur të gjitha mbeteshin në mes të udhës. Një çast kur çdo ngjarje, çdo mendim, çdo aromë, çdo fjali, me përjashtim të sharjeve të ndyra dhe mallkimeve, mbeteshin përgjysmë. Vetëm vezullimi i mbytur, turbullues, i Varrit të Qyqit netëve, nuk ndërpritej. Pak vetë e vinin re atë mashtrim pamor, me të cilin Varri i Qyqit sundonte mbi qytezë. Përndritja nëntokësore forcohej jo kur nata ishte pa yje, por në të rënë të mbrëmjes, në ato minuta përgjumëse e ëndërrore kur beson se të gjitha ndodhin në një rrëfenjë.

Vegimi i Rubin Shkretës i kishte rrënjët në disa nga ato minuta, në brinjë të kodrinës ku prehej Varri i Qyqit. Rreth dhjetë djem të vegjël, që nuk njiheshin me shoshogin, ishin mbledhur vetiu, thjesht të joshur nga vezullimi i eshtrave. Njëri pat thënë se ato nuk qenë eshtra, por monedha prej floriri të bardhë, ose prej argjendi, dhe se, kur të rritej, me kazmë e lopatë, do ta hapte atë thesar e do t'ia dhuronte Partisë. Do ta bënin Hero të Punës Socialiste, ose edhe Hero të Popullit. Nja dy djem të tjerë ishin zgërdheshur në muzg, jo aq nga ëndrrat e heroit të ardhshëm, se sa nga inati që ky plan i kish ardhur më parë në mend atij qurrashi e jo atyre.

Rubin Shkreta i vogël ish mahnitur. Nuk arrinte ta ndante pasurinë nga vdekja, arin nga eshtrat, tmerrin e mundshëm të zbulimit të një thesari nga lemeria e të fshehtave që kazma e lopata mund të nxirrnin nga një varr qyqi. Nata që ulur ngadalë; erërat sëmurëse të fabrikës së tullave dhe të një uzine të fshehtë ku

prodhoheshin bomba a tanke për mbrojtjen e atdheut qenë turrur t'u thithnin edhe nga pak gjak mushkërive të së ardhmes, kurse ata ishin ulur më bythë në rrëzë të kodrinës, me sytë shajnitur drejt Varrit të Qyqit që i ngjante një anijeje kozmike. Edhe tani, pas dyzet e ca vjetësh, ia mbushte zemrën me morrnica frika vërtet e panjohur e atyre minutave. S'mbante mend cili syresh pat thënë me zë të ulët, - me një nga ata zëra që përdoren për të vendosur vrasjen e ndonjë grupi foshnjash apo qëniesh të pafajshme në përgjithësi:

- Haj t'i bjemë me dorë!... T'i bjemë me dorë, thashë!

Dhe kishin filluar t'i bënë mavi falluset e vegjël që do të pëmirësonin racën, në kor, e Rubin Shkretës i dukej sikur po torturonte me gishta një kokërdhok të verbëri, një sy që rrekej e s'ia dilte mbanë të shihte të paparar. Kish mardhur nga tmërri se mos i kapte kush, thua se po u binin me dorë ca falluseve të ndaluar apo se po nguteshin të vrisnin pa mëshirë ndokënd.

I.

Në ferr shkon vetëm ajo pjesë e jona që s'don të vdesë, përsëriste në gjumë. Mund të ish fjala për shpirtin, por edhe për kujtesën. Nuk dinte cila pjesë e vetes ngulmonte të soste në ferr, por ndihej njëfarësoj i lumtur që kthjelltia e muajve të parë në mërgim, ajo fjetje vetëm e trupit, - me sy shpirti e kujtese hapur, - nuk e paskësh braktisur as pas kaq vitesh jashtë. Në çaste të tillë ua zhbironte thelbin gjërave më mirë, më me siguri.

Përjashta sapo kish bujtur tetori. Një zë që sikur pëshpëritej nga plisat e tharë të Varrit të Qyqit e njoftonte se ky tetor dukej pa të reja, si të gjithë tetoret e jetës së tij, mirpo nuk ishte krejt ashtu. Ky tetor që shndërruar tinëz në njëfarë syri të zi, më të zi se rrathët e ferrit, e ai sy do t'i mbështetej tani mu në lug të ballit. Gishtat e duarve dhe lëkura e zemrës do t'i bëheshin akull nga ajo prekje. Dhe mund të zgjohej po të donte, të bënte disa herë kryqin me gjuhë brenda qiellzës së thartuar nga konjaku e duhani, që t'i dilte kthetrash asaj ëndrre. Ëndrra vjeshte, shqiptoi me gjuhën që kish nisur të kryqohej vetvetiu, këto nuk dalin, po cili je ti që ngulmon të më llahtarisësh, cili je ti, pyeti disa herë në terr - dhe hapi sytë.

Kushedicili nuk e paskësh gënjyer. Syri i tetorit ishte bërë grykë revolveri. Nuk ishte hera e parë që jeta ua kalonte në befasi të gjitha ëndrrave të vjeshtës. Doreza e revolverit qënkej grusht njeriu, kurse grushti u zgjatkej, marrkej trajtën e një krahu

të dobët, lakuriq, vidhosur në supin e majtë të një fëmije.

Ose anasjelltas.

Dy sy si gryka revolverësh të fshehur mirë brenda kafkës së një fëmije, - sy të zinj e me atë mungesë mëshire e nënqeshje të epërme që vezullon në fytyrat e atyre fëmijëve që kanë provuar urinë, - i mbanin ison syrit të hekurt të atij tetori.

Kërcënuesi ishte mëngjërash.

Kjo i shkëlqeu trush një grimë para se ta përfytyronte paraprakisht tërheqjen e këmbzës, brofjen e truve të veta nga kafka dhe derdhjen e stërkalave të truve mbi fytyrën hyjnore, mbi qafën drithëruese prej mjellme dhe mbi gjinjtë e Sonyës. Gropëza e plumbit do ta bindte me lehtë se që aty ish pjellë rrufeshëm dhe egërsisht një foshnjë e jo një shkulum trush.

Sonya shihte ndonjë ëndërr vjeshte dhe as që kish si ta merrte me mend se, nga çasti në çast, rrezikonte të bënte tualet në gjumë me ca tru shqiptari.

Kërcënuesi bëri dy lëvizje kuptimplota në të njëjtin çast. Rubin Shkreta pati një lehtësim pothuajse qiellor: aq dëshirë paskësh pasur të vdiste, saqë tani, nëse jepte shpirt, ajo dëshirë do ta mërgonte të tërin, pa e pjestuar, në Parajsë.

Kërcënuesi vuri pingul gishtin e dorës së djathtë para gojës (*le të mbajmë një grimë zi para se të t'i zbardhim makthet, bukurosh...*) - dhe drejtoi shkarazi, shkurt, tytën e revolverit nga Sonya.